



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11218 Prot

Lezhë, më 14 / 06 /2022

VENDIM

Nr. 57, Datë 13 . 06 .2022

PËR

MIRATIMIN E PRIORITETIT PËR “FINANCIMIN E SHOQATAVE SPORTIVE TË FEDERUARA ME OBJEKT FUTBOLLIN” PËR TË PËRFAQËSUAR LEZHËN NË KOMPETICIONE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE DHE PËR TË NXITUR TË RINJTË E TALENTUAR NË FUTBOLL NË BASHKINË LEZHË

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, ligjit nr. 79 “Për sportin”, ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, neni 20 dhe neni 21, Planit Strategjik për Zhvillimin e Qendrueshëm të Komunitetit të Lezhës 2013-2030, qëllimi nr. 4 “cilësia e jetës dhe komuniteti janë aktivitetet nr. 121, 122, 123, 125 si dhe vendimit nr. 209, datë 23.05.2018 “Rregullore mbi Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Lezhë dhe Njësive Administrative”, neni 62, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e prioritetit për “Financimin e shoqatave sportive të federuara me objekt futbollin” për të përfaqësuar Lezhën në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të nxitur të rinjtë e talentuar në futboll në Bashkinë Lezhë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

